



KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

01 Nr. 345-36546/21

DATE 08.10.2021

**KONTRATË NR 90-2021**

**KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"),  
në njërën anë; dhe

**QLIRIM JUSUFI B.I. GRABANICE KLINE**, me nr.unik 810205121, te  
cilen e perfaqeson Qlirim Jusufi (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër,  
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

**ORGANIZIM I AKTIVITETIT ME NXENES - VIZIT STUDIMORE NGA  
PROJEKT SAVE THE CHILDREN**

me numër identifikues: 634-21-6071-2-4-7

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e  
Kontraktuesit:

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat etj)	Çmimi Total - €
1	<b>Organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin e nxënësve për ushqimim e shëndetshem. Ne</b> vizite do të përfshihen 25 nxënës të klases parafillore dhe, mësimdhënësja, drejtori, sekretari dhe 2 prinder;. <b>Transporti :</b> Përfshin relacionin <b>Drenoc- Klinë ( fabrika AMORETI )</b> dhe anasjelltas. <b>Ushqimi :</b> Mengjesi: kifile me eurokrem	TOTAL	1	230.00	230.00

	dhe uij 0.33l, Dreka: Mundesi perzgjedhje ( hamburger komplet, pizza 0.30 cm ose 7 qebapa me mish te bardhe) dhe nje pije lëngje frutash 0.5 l				
2	<b>Organizimi i aktivitetit me nxënës vizite në pyllin e arinjeve Prishtina.</b> Ne vizite do të përfshihen 25 nxënës te klases parafillore, mësimdhënësja, drejtori, sekretari dhe 2 prinder. Te sigurohet transporti dhe ushqimi per 30 persona. <b>1.Transporti:</b> Perfshin relacionin <b>Drenoc- fshati Mramor (Prishtine)</b> dhe dhe anasjelltas. Autobusi duhet te jete me klime. Te sigurohet pagesa per hyrje ne pyellin e arinjeve Prishtina per 30 persona <b>Ushqimi:</b> <b>Mengjesi:</b> kifile me eurokrem dhe uij 0.33l, <b>Dreka:</b> Mundesi perzgjedhje nga nxenesit (Hamburger, pizza 0.30 cm ose 7 qebapa me mish te bardhe) dhe nje pije lëngje frutash 0.5l	TOTAL	1	419.00	419.00
				<b>Totali i PËRGJITHSHËM</b>	<b>649.00</b>

## Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **649.00 €**; ( Gjashtëqindëzetënetëeuro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3. Plani per kryerje te puneve eshte sipas agjendes nga Programi i Shkolles dhe Save the Children .

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Me raport mbi kryern e puneve nga \komisioni dhe fature

2.5. Kryesi i shërbimeve do te mbaj pergjegjesi per transport dhe shërbime ndaj nxenesve ne tere aktivitetin nga nisja deri ne kethim .

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën <sup>1</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA KLINE

Emri:	<i>Adnan Beqari</i>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit <i>Drejtori i Kollës</i>
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>08.10.2021</i>
Vula:	

Për Kontraktuesin QLIRIM JUSUPI B.I. – KLINE

Emri:	<i>Qlirim Jusup</i>
Pozita:	<i>DREJTOR</i>
Nënshkrimi:	<i>Jusup</i>
Data:	<i>08.10.2021</i>
Vula:	

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.